



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА Е МАКЕДОНИСË СË

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 96-të të mbajtur më 27.11.2023, ka miratuar sa vijon,

VENDIM

Denoncimi I regjistruar me numër 12-26/1 nga 03.01.2023, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja përcaktoi se denoncimi përmban pretendime që ajo i konsideron se nuk janë në juridiksionin e saj, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Lënda me numër 12-26/1 nga 03.01.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Me datë 03.01.2023 kundër gjyqtarit të _____ është parashtruar denoncim nga një parashtrues i njohur dhe është formuar lënda me numër 12-26/1 e datës 03.01.2023.

Në denoncim, parashtruesi pretendon kryerjen e pakujdesshme të funksionit gjyqësor në një proces gjyqësor për zbatimin e procedurës së verifikimit, ndërsa aktgjykimi i dhënë për ndryshimin e pronësisë ndaj një personi tjetër i ka shkaktuar dëm nga e drejta

individuale për faktin se ai konsiderohet trashëgimtar i vetëm i pasurisë pas vdekjes së prindit.

KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Krahas kërkesës janë paraqitur edhe dëshmi.

Sipas pretendimeve të theksuara në denoncim, KSHPK-ja konstatoi se nuk kishte elemente për veprimin e saj kompetent, për këtë arsye mori vendim për refuzimin e kërkesës.

Përveç kësaj, dhe duke marrë parasysh se denoncimi nxjerr në pah pretendimet për sjellje të paligjshme nga një gjyqtar, KSHPK e udhëzon parashtruesin për mundësinë e paraqitjes së ankesës në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dërguar:

- parashtruesi i denoncimit

përgatiti: P.B

miratoi: G.T anëtar i KSHPK-së.

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska